

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë!

Faleminderit të gjithë kolegëve që janë këtu sot pas një dite maratonë!

Në fakt, është goxha e lodhshme, por patjetër që buxheti kërkon lodhje, sakrifica nga të gjithë ne. Dua ta nis fjalën me falënderime dhe me mirënjohje për të gjithë kabinetin qeveritar dhe Kryeministrin, Rama, për të gjithë kolegët deputetë, të cilët janë angazhuar dhe kanë punuar në kohë krize!

Detyra e qeverisë është të kujdeset për qytetarët dhe nëse bën këtë ka bërë thjesht detyrën, por ta bësh detyrën në një kohë krize është patriotizëm. E them këtë pasi shumë vende, edhe më të forta se ne ekonomikisht, kanë dorëzuar mandatin e qeverisjes dhe janë tërhequr, duke thyer besën e atyre që i kanë votuar. Kjo qeveri jo vetëm që nuk do të tërhiqet, por do të vazhdojë, do t'ia dalë dhe duhet t'ia dalim për të gjithë qytetarët tanë.

Ky është një moment ku pa diskutim duhet bërë një rezymë, edhe pse jo në detaje, për të gjithë punët që kemi bërë dhe ato që do të bëjmë. Ne kemi treguar që në situata të veçanta dhe aspak të zakonshme, siç është tërmeti i vitit 2019 apo dhe më vonë pandemia, ia kemi dalë duke qenë të gjithë bashkë. Por për fat të keq, nga ana e opozitës kemi pasur vetëm panik, pesimizëm dhe asgjë konkrete për zgjidhje të situatave. Përsëri jemi të vetëdijshëm që po bëjmë më të mirën e mundshme, në kushtet kur askush nuk e di sesa e gjatë do të jetë kjo luftë. Në këto kushte duhet të jemi të përgatitur jo vetëm për të tashmen, por dhe për të ardhmen. Ne kemi zgjedhur të mos e rrisim çmimin e energjisë elektrike, ky është një fakt, që të gjithë qytetarët shqiptarë përfitojnë dhe të gjithë bashkë duhet të bëjmë më të mirën, duhet të japim kontributin tonë, që nga qytetari më i thjeshtë dhe deri tek titullarët e institucioneve.

Më lejoni të sjell një shembull të mirë, se si të gjithë bashkë mund t'ia dalim. Ne e dimë se dimri që po afron nuk është aspak i zakonshëm, është një dimër shumë i fortë, shumë i ftohtë, ku shumë familje në

nevojë kanë nevojë për ngrohje, kanë nevojë për siguri, kanë nevojë për të ndjerë dorën e shtetit pranë. Bashkia e Elbasanit ka gjetur një zgjidhje, duke u dhënë të gjithë qytetarëve në nevojë, familjeve në nevojë dhe pensionistëve dru me çmimin 50% më lirë sesa çmimi i tregut. Pra, ky është një shembull i mirë, sesi mund ta zgjidhim një situatë, e cila nuk është aspak e zakonshme.

Për të dalë më konkretisht te projektbuxheti i vitit 2023. Edhe pse kohë krize vijojmë të mbajmë të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike për familjet dhe shumicën e bizneseve, duke alokuar një mbështetje buxhetore prej 12 miliardë lekësh për sektorin energjetik.

Tjetër element shumë i rëndësishëm është mbështetja ndaj familjeve me të ardhura më të ulëta, duke rritur pragun e patatueshëm nga 40 mijë në 50 mijë lekë. Nga kjo masë do të përfitojnë mbi 70 mijë të punësuar. Mbështeten familjet dhe individët në nevojë përmes zbatimit të paketës së re të rezistencës, në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike, ku përfitojmë mesatarisht rreth 220 mijë individë në vit. Do të ketë një kosto më të lartë në krahasim me vitin 2022, 2,4 miliardë më shumë sesa buxheti i parashikuar më parë.

Brenda politikave sociale është risi për vitin 2023 politika me kosto rreth 600 milionë lekë për mbështetjen e veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri në 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në 5 vjeç.

Në projektbuxhetin e vitit 2023 parashikohet një garanci sovrane për mbështetjen e 1000 familjeve të reja për blerjen e banesës, për herë të parë, ku të paktën një anëtar punon në administratë, punon si profesionist i lirë apo infermier.

Ky projektbuxhet është kujdesur të ketë prioritet sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, ku patjetër që do të ketë ndihmë ekonomike për të gjitha familjet në nevojë si në sektorin e arsimit, po ashtu dhe të çështjeve sociale.

Shëndetësia do të vijojë të financohet si sektor prioritar me fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe dytësore, si dhe duke motivuar në vijimësi personelin shëndetësor me rritjen e pagave.

Pagat e të gjithë administratës vendore për vitin 2023 do të jenë të rritura. Rriten pagat në buxhetin e vitit 2023 për funksionet: arsim parashkollor, arsim parauniversitar, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri,

administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi me një fond prej 340 milionë lekësh. Për vitin 2023 kemi një rritje prej 2,6% në krahasim me vitin e kaluar.

Po të dalim te shëndetësia, për sa i përket qytetit të Elbasanit nga vij unë, kemi pasur një rikonstruksion total të pediatriisë për vitin 2022, gjë që e dimë të gjithë, sepse spitali i fëmijëve duhet të jetë në kushte optimale, që të ngjallë shpresë dhe jo frikë për fëmijët që shkojnë të trajtohen, ndaj dhe prindërit e tyre nguronin t'i çonin për trajtim. Në pediatriinë e Elbasanit kishte më shumë se 60 vjet që nuk ishte vënë dorë. Edhe pse në kohë krize, buxheti garanton 100% mbulim falas të paketave mjekësore të dializës, transplantim të veshkave, kardiologjisë, kardiokirurgjisë, radioterapisë dhe kataraktit.

Gjithashtu, do të vazhdojë edhe ekzaminimi i kancerit të gjirit apo i diagnozave të tjera, që janë për të parandaluar dhe për të rritur mirëqenien e grave, atyre që sjellin jetë, sepse, siç thotë dhe një citat: “Kush shpëton një jetë, është njëloj sikur ka shpëtuar të gjithë njerëzimin”. Kjo tregon se jeta për ne nuk është vetëm e shtrenjtë, por është dhe e shenjtë.

Doja të sillja në fokus për këtë projektbuxhet një falënderim edhe për Ministrinë e Rinisë dhe Fëmijëve, sepse në komisionet ku unë jam pjesë, ka sjellë...

Nuk është, siç keni mbetur dhe ju dy veta.

Falënderimi nuk është që duhet të jetë patjetër personi, por puna dhe stafi i palodhur i kësaj ministrie ka sjellë në projektbuxhetin e vitit 2023 të gjithë kërkesat e të rinjve. Në këtë projektbuxhet të gjithë të rinjtë e gjejnë veten të përfshirë për sa u përket zejeve, arit, kulturës që do të bëhen në shkollat 9-vjeçare apo në shkollat e mesme. Mjafton të shikojmë arsimin dhe shëndetësinë, se edhe në kohë krize ne nuk ndalojmë, pra sa të rëndësishme janë për ne arsimi dhe shëndetësia.

Do të shikojmë që buxheti i vitit 2023 do të ketë në sistemin arsimor shtim të stafeve psikosociale dhe mësuesit e ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta, çka tregon se fëmijët për ne janë të parët, janë prioritet, edhe pse në kohë krizash, ne dimë t'i menaxhojmë situatat dhe t'u qëndrojmë pranë familjeve që kanë fëmijë me nevoja të veçanta.

Për sa u përket investimeve në qytetin e Elbasanit do të doja të ndalesha edhe te një vepër madhore siç është automotoparku i Elbasanit, pista e garave të “Formula 1”, që besoj se është e para në Shqipëri, por dhe në Ballkan.

A mjaftojnë të gjitha këto? Jo, por kemi të gjithë kurajën dhe guximin të ecim përpara dhe të mos ndalemi. Sot është momenti të jemi të gjithë bashkë si shqiptarë, siç i ka hije kësaj Shqipërisë sonë të bukur, që të bëjmë më të mirën për ata që na kanë besuar.

Faleminderit!